



Eficienca e buxhetit të Bashkisë Sarandë (Viti 2021)

1. Analiza e parashikimit të të ardhurave për vitin fiskal 2021

Studimi ka për qëllim të analizojë eficiencën dhe shpenzimet e të ardhurave për vitin 2021, e cila do të na ndihmojë të shohim se ku janë përfitimet, problematikat dhe pritshmëritë.

Projekti financohet nga UNDEF dhe zbatohet nga ARZH (Agjensia Rajonale e Zhvillimit) dhe EIC (Economic Intelligence Center) Korçë.

Bazuar në Ligjin nr. 9632, “Për sistemin e taksave vendore”, bashkitë kanë të drejtë të vendosin taksat e tyre +/- 30% nga taksa e miratuar në Ligj, ndërsa tarifatat mund të rriten, zvogëlohen, shtohen apo hiqen me miratim të Këshillit Bashkiak, sipas nevojave të Bashkisë. Ndërsa transfertat janë fonde, të cilat u delegohen bashkive sipas parashikimeve ligjore dhe funksioneve shtesë që mori pushteti vendor nga Reforma Administrative Territoriale.


Më poshtë jepen të ardhurat totale të bashkisë:

Tabela 1. Të ardhurat totale të Bashkisë sipas burimeve

Burimet e financimit	(Vlera në 000 Lekë)	% mbi totalin e të ardhurave 2021
Transferta e pakushtëzuar (fondi i deleguar nga Qeveria në funksion të Bashkive për përdorim të lirë)	145,312	11 %
Transferta e kushtëzuar (fondi i deleguar nga Qeveria në funksion të Bashkive për përdorim të përcaktuar)	103,707	8 %
Transferta e pakushtëzuar sektoriale (fondi i deleguar nga Qeveria në funksion të Bashkive për përdorim të përcaktuar)	225,000	17 %
Të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore (të ardhurat nga detyrimet e qytetarëve kundrejt Bashkisë)	432,000	33 %
Të ardhura të tjera (të ardhura nga institucionet që Bashkia ka nën varësinë e saj)	190,000	15 %
Fondi i Zhvillimit të Rajoneve	200,000	16 %
TOTALI	1,296,019	100%

Burimi: Bashkia Sarandë (Ilogaritje EIC)

Figura 1. Të ardhurat totale, Bashkia Sarandë 2021



Burimi: Bashkia Sarandë (Ilogaritje EIC)

2. Analiza e shpenzimeve të Bashkisë Sarandë për vitin fiskal 2021

E rëndësishme për qytetarët është procesi i shpërndarjes së fondeve, ose e thënë ndryshe, ku shkojnë paratë e taksapaguesve; përse shpenzohen nga bashkia?


Analiza më poshtë do marrë në konsideratë shpenzimet afatshkurtra dhe ato afatgjata për vitin 2021. Më poshtë po japim tabelën përmbledhëse të shpenzimeve:

Tabela 2. Shpenzimet totale të Bashkisë sipas programeve dhe raporti mbi të ardhurat totale 2021

Emërtimi i shpenzimit	(Vlera në 000 Lekë)	% mbi totalin e të ardhurave 2021
Shpenzime Paga+Sig.Shoqërore	300,433	23 %
Shpenzime Korrente	333,189	26 %
Shpenzime për Investime	417,275	32 %
Shpenzime të tjera	245,123	19 %
TOTALI	1,296,020	100 %


Burimi: Bashkia Sarandë (Ilogaritje EIC)

Figura 2. Shpenzimet totale si raport mbi të ardhurat totale 2021



Burimi: Bashkia Sarandë (Ilogaritje EIC)

Figura 3. Shpenzimet për paga/sig. shoqërore si raport mbi të ardhurat lokale 2021



Burimi: Bashkia Sarandë (Ilogaritje EIC)